



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.66, datë 24.09.2018

PËR

“DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË DOKUMENTIN E TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHZ (792-862 MHZ)”, REF. 1X10 MHZ I ÇIFTUAR-800-2018”, MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT DREJTUES NR. 47, DATË 5.7.2018”.

Këshilli Drejtues (**KD**) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (**AKEP**), i përbërë nga:

- | | | |
|-----------------|----------|---------|
| 1. Z. Ilir | Zela | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira | Dvorani | Anëtar |
| 4. Znj. Ketrin | Topçiu | Anëtar |
| 5. Znj. Klarina | Allushi | Anëtar |

dhe sekretare e Këshillit Drejtues Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 24.09.2018, konform procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 7 datë 16.02.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Disa shtesa dhe ndryshime në dokumentin e tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 Mhz (792-862 MHz)”, ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 6.2, Kreu III i VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënie e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar;
2. Rregullore e brendshme e funksionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7 datë 16.02.2018 të KD të AKEP;

3. Urdhri Nr.404 i Kryetarit të KD-së së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike datë 28.06.2018 “Për zhvillimin e procedurës për konkurimin publik për dhënien të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)”, i ndryshuar;
4. VKD nr.47, datë 05.07.2018 për “Miratimin e dokumentit të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018;
5. Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- a. Projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;
- b. Relacion shpjegues;

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

Përmbajtja e Shtojcës 6, “**Formulari i Planit për Shtrirjen dhe Konfigurimin e Rrjetit që do Ndërtohet për Mbulimin me Shërbim**”, të dokumentave të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2018”, nuk shprehet qartësisht se kujt i referohet detyrimi për mbulim të territorit me shërbim LTE, ndërkohë që sipërmarrësit që operojnë aktualisht në treg e kanë mbuluar një pjesë të konsiderueshme të territorit me këtë shërbim.

Në referim të pikës 6.2 të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar parashikohet: “*AKEP, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave të tenderit dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një kandidat, mund të bëjë ndryshime në dokumentin e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë kandidatëve blerës, që kanë tërhequr dokumentin e tenderit, dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast, AKEP e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me të paktën 5 ditë*”, AKEP, duke synuar saktësimin e detyrimit për mbulim, për sa parashikohet në këtë Shtojcë sugjeron shtimin në Shtojcën 6 të Dokumentit të Tenderit me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 mhz (792-862 mhz)”, ref. 1x10 mhz i çiftuar-800-2018”, saktësisht menjëherë pas tabelës “**Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual**”, Shënimin si më poshtë: “*Kolona e deklarimit për mbulim me shërbim do të aplikohet vetëm për ofruesit e rinj të shërbimit 4G*”.

Ndryshimi i shtojcës 6, “**Formulari i Planit për Shtrirjen dhe Konfigurimin e Rrjetit që do Ndërtohet për Mbulimin me Shërbim**”, synon të sqarojë se përmbushja e përcaktimeve të shprehura në kolonën e deklarimit për mbulimin e territorit i referohet sipërmarrësve të rinj që eventualisht parashikojnë të ofrojnë këtë shërbim, ndërkohë që operatorët ekzistues, tashmë kanë realizuar mbulimin e territorit me shërbimin LTE.

Në vëmendje të shtesës dhe ndryshimit të lartpërmendur në dokumentet e tenderit, AKEP, referuar përcaktimit ligjor të shprehur në pikën 6.2 të të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, e ndryshuar, zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertave, nga operatorët e interesuar, deri në datën 3 Dhjetor 2018.

Vlen të theksohet se shtesat dhe ndryshimet në shtojcën 6, të dokumenteve të tenderit, duke shtyrë dhe afatin e zhvillimit të tenderit sipas parashikimeve ligjore dhe të akteve nënligjore në fuqi, pavarësisht qëndrimeve zyrtare të AKEP, reflektojnë dhe kërkesën e paraqitur nga operatorët në treg, konkretisht “Albtelekom sh.a.” me shkresë nr.7830 Prot, datë 03.08.2018 dhe “Vodafone Albania sh.a.” me shkresat Nr. 2112 Prot, datë 09.08.2018, Nr. 688/23 Prot, datë 13.09.2018 dhe Nr. 688/27 Prot, datë 24.09.2018.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe pikës 6.2 të Kreut III të VKM-së Nr.1252 datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në shtojcën 6 të dokumentit të tenderit.
2. Të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertës deri në datën 3 Dhjetor 2018 dhe ky afat i ndryshuar të reflektohet në të gjithë dokumentin e tenderit publik.
3. Ngarkohet njësia e hartimit të dokumenteve të ndjekë procedurën për sa parashikohet në këtë vendim.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Ilir ZELA

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Edlira DVORANI
3. Ketrin TOPÇIU
4. Klarina ALLUSHI

SHTOJCA 6

FORMULARI I PLANIT PER SHTRIRJEN DHE KONFIGURIMIN E RRJETIT QE DO NDERTOHET PER MBULIMIN ME SHERBIM

(Dokument me stemen dhe simbolet e Ofertuesit)
Procedure Hapur

Ofertuesi	----- (emri i ofertuesit)
-----------	---------------------------

DEKLARATE

I nenshkruari _____ (emri, atesia, mbiemri), person i autorizuar te veproj ne emer te ofertuesit _____ (emri i ofertuesit) nepermjet kesaj deklarate konfirmoj se, nese ofertuesi do te marre Autorizimin Individual, do te ndertoje dhe konfiguroje rrjetin per te realizuar shtrirjen gjeografike te mbulimit me rrjet dhe sherbime te komunikimeve elektronike, sipas afateve dhe percaktimeve si me poshte:

Periudha nga koha e marrjes së Autorizimit Individual	Shënime
Deri në fund të 6 mujorit të parë	Jo më pak se 25 % të territorit
Deri në fund 12 muajve	Jo më pak se 50 % të territorit
Deri në fund të 18 muajve	Jo më pak se 75 % të territorit

Shënim. Kolona e deklarimit për mbulimin me shërbim do të aplikohet vetëm për ofruesit e rinj të shërbimit 4 G.

Koha e fillimit te shfrytezimit te frekuencave do te jete jo me vone se dy muaj nga data e pajisjes me Autorizimin Individual nga AKEP.

Si operator aktual në treg, i pajisur nga AKEP me autorizime te meparshme individuale për përdorimin e frekuencave për teknologjitë GSM, UMTS, IMT-LTE etj, deklaroj qe detyrimet e mbulimit me rrjet dhe shërbime te komunikimeve elektronike sipas këtyre autorizimeve, do ti ndjek paralelisht me detyrimet e autorizimit të ri individual (1x10 MHz i çiftuar, ne brezin 800 MHz: 790-862 MHz) sipas afateve dhe percaktimeve te mesiperme, kerkesat e Ligjit 9918 i ndryshuar, si dhe bazuar ne te gjitha Autorizimet Individuale do te bejme perpjekjet maksimale per te synuar mbulimin në total të territorit te Republikes se Shqiperise ne kohe sa me te shpejte dhe brenda afateve te vlefshmerise se Autorizimeve Individuale, duke perfshire bashkepunimin me AKEP per kete qellim.

Si operator i ri në treg, do te zbatoj detyrimet e autorizimit individual (1x10 MHz i çiftuar, ne brezin 800 MHz: 790-862 MHz) sipas afateve dhe percaktimeve te mesiperme, kerkesat e Ligjit

9918 i ndryshuar, si dhe do te bejme perpjekjet maksimale per te synuar mbulimin në total të territorit te Republikes se Shqiperise ne kohe sa me te shpejte dhe brenda afateve te vlefshmerise se Autorizimit Individual, duke perfshire bashkepunimin me AKEP per kete qellim.

Personi i Autorizuar _____ Date xx,xx, 2018
(emer, mbiemer, firme, vule)